



*Duke Mbështetur Qeverisjen e Mirë dhe Qytetarinë Aktive
Supporting Good Governance and Active Citizenry*

HULUMTIM MBI PARTITË POLITIKE

KORRIK, 2015

Metodologjia dhe Mostra e Hulumtimit

Ky hulumtim, i cili është i bazuar në metodën sasiore, është zhvilluar në 38 komuna të Kosovës. Për përcaktimin e mostrës në këtë hulumtim është përdorur teknika e “mostrës së shtresuar të rëndomtë,” me ç’rast popullata e përgjithshme është ndarë në grupe më të vogla që në literaturën shkencore njihen si *shtresa*, varësisht nga karakteristikat e përbashkëta të pjesëtarëve të këtyre shtresave. *Shtresimi i parë* është bërë në bazë të përkatësisë etnike, ku janë krijuar tri nën-grupe të ndryshme. *Shtresimi i dytë* është bërë në bazë të vendbanimeve; për secilën komunë është bërë shtrirja e mostrës në pjesët urbane dhe rurale, sipas statistikave zyrtare të ASK-së. *Shtresimi i tretë* është bërë në bazë të numrit të anketave të realizuara në secilin vendbanim (pika startuese). Pikat startuese në këtë hulumtim janë përcaktuar sipas metodës së rastësisë. Koha e realizimit të hulumtimit është zhvilluar në teren nga data 10 deri me 28 Maj 2015. Ky hulumtim ka nivel të besueshmërisë prej 95% me marzhë të gabimit +-3.1%.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë anketuar 1000 qytetarë të Kosovës; rreth 93% e të anketuarve kanë qenë nga komuniteti shqiptar, 4% nga ai serb, 1.2% ashkalinj, 0.5% goran, 0.5% turq, 0.4% boshnjak dhe 0.4% rom.

Mostra më pas është peshuar, për të reflektuar strukturën etnike në Kosovë. Para se të administrohet pyetësori në teren fillimisht është bërë testimi i pyetësorit për të identifikuar problemet logjike dhe përmbajtësore, si dhe është zhvilluar trajnimi i anketuesve.

Përzgjedhja e të anketuarve është bërë përmes këtyre tre fazave:

FAZA E PARË: Përzgjedhja e shtëpisë përmes teknikës së ecjes sistematike të rastit

Në këtë fazë anketuesi nga pika startuese ka përzgjedhur çdo të tretën shtëpi në anën e majtë të rrugës. Në rastet kur shtëpia ka qenë e pabanuar ose kur anketuesi është refuzuar, njësia e banimit është kaluar dhe është vazhduar me qasjen sistematike.

FAZA E DYTË: Pyetjet përjashtuese - Identifikimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë

Në këtë fazë është bërë identifikimi dhe kontaktimi i kandidatit të përshtatshëm për intervistë. Për këtë fazë, UBO Consulting ka përzgjedhur anëtarin me moshë mbi 18 vjeçare dhe që ka datëlindjen e ardhshme më së afërmi.

FAZA E TRETË: Zhvillimi i intervistave ballë-për-ballë


Gjatë përgatitjes për intervistë, intervistuesi ka sqaruar rëndësinë e të përgjigjurit në bindjet personale të të intervistuarit, ku preferencë i është dhënë që intervista të realizohet pa prezencën e anëtarëve të tjerë të familjes.

Në kuadër të këtij hulumtimi janë përfshirë gjithsej 28 anketues dhe 7 mbikëqyrës regjionale të cilët kanë monitoruar në baza ditore punën e anketuesve në teren. Kontrolli i cilësisë së anketimit është bërë edhe pas përfundimit të punës në teren, përmes verifikimit (thirrjeve telefonike dhe vizitave) të 30% të anketave të realizuara. Të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në programin SPSS, prej edhe nga janë fituar rezultatet e këtij raporti.

Seksioni i Zgjedhjeve


Lëvizja FOL gjatë realizimit të hulumtimit të opinionit publik i ka pyetur qytetarët rreth mbarëvajtjes së dy palë zgjedhjeve të fundit në Kosovë dhe rreth preferencave që ata kanë për partitë politike.

Ata fillimisht janë pyetur nëse para zgjedhjeve të fundit të përgjithshme ndonjëra nga partitë e caktuara politike u ka kërkuar votën në shkëmbim të ndonjë shërbimi, paraje ose dhurate. Në këtë pyetje, sipas të gjeturave të hulumtimit, rezulton se 17% e të anketuarve kanë deklaruar t'u kenë dhënë votën në shkëmbim të ndonjë të mire materiale, ndërsa 83% e të anketuarve e kanë mohuar t'u ketë ndodhur një gjë e tillë. Në këtë pikë, qytetarët e anketuar janë pyetur po ashtu nëse para zgjedhjeve të fundit të përgjithshme ndonjëra nga partitë e caktuara politike u ka kërkuar votën ndonjë anëtarit të familjes në shkëmbim të ndonjë shërbimi, paraje ose dhurate. Siç tregojnë të dhënat e këtij hulumtimi, rreth 11.2% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar se kjo nuk u ka ndodhur asnjëherë, dhe vetëm 3.1% e tyre kanë deklaruar se nuk e dinë t'u ketë ndodhur apo jo.



Graf. 1. Para zgjedhjeve të fundit të përgjithshme a ka kërkuar ndonjë parti politike vota nga ju apo nga anëtarët e familjes tuaj në shkëmbim të ndonjë shërbimi, paraje ose dhurate?

Gjithashtu, qytetarët e anketuar janë pyetur nëse para zgjedhjeve të fundit komunale ndonjëra nga partitë e caktuara politike u ka kërkuar atyre votën në shkëmbim të ndonjë shërbimi, paraje ose dhurate. Bazuar në të gjeturat faktike të këtij hulumtimi, rreth 15.5% e të anketuarve kanë deklaruar t’u kenë dhënë votën në shkëmbim të ndonjë të mire materiale, ndërsa 84.5% e kanë mohuar t’u ketë një gjë e tillë. Në këtë kontekst, qytetarët e anketuar janë pyetur nëse para zgjedhjeve të fundit komunale ndonjëra nga partitë e caktuara politike u ka kërkuar votën ndonjë anëtarit të familjes së tyre në shkëmbim të ndonjë shërbimi, paraje ose dhurate. Siç tregojnë të dhënat e hulumtimit, rreth 12.5% e kanë pohuar një gjë të tillë, 83.5% kanë deklaruar se kjo nuk u ka ndodhur, ndërsa 4% e të anketuarve janë shprehur se nuk e dinë t’u ketë ndodhur një gjë e tillë.




Graf. 2. Para zgjedhjeve të fundit lokale a ka kërkuar ndonjë parti politike vota nga ju apo anëtarët e familjes në shkëmbim të ndonjë shërbimi, paraje ose dhurate.

Preferencat e Qytetarëve mbi Partitë Politike


Gjatë realizimit të këtij hulumtimi Lëvizja FOL gjithashtu i ka pyetur qytetarët rreth preferencave të tyre për partitë politike në vend. Në këtë kontekst, sidoqoftë, duhet të pasur parasysh që hulumtimi është zhvilluar në terren nga data 10 deri më 28 Maj 2015.

Fillimisht, qytetarët janë pyetur se nëse pas një jave do të zhvilloheshin Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ti votonit? Rreth 18.7% e të anketuarve janë përgjigjur se do ta votonin Partinë Demokratike e Kosovës - PDK, rreth 17.70% e të anketuarve janë përgjigjur se do ta votonin Lidhjen Demokratike e Kosovës - LDK, rreth 16.60% e të anketuarve janë përgjigjur se do ta votonin Lëvizjen VETVENDOSJE- LVV, rreth 4.20% e të anketuarve janë përgjigjur se do ta votonin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës - AAK, rreth 2.50% e të anketuarve janë përgjigjur se do ta votonin Listën Serbe - LS, rreth 1.50% të anketuarve janë përgjigjur se do ta votonin Nismën për Kosovë - NISMA, rreth 1.20% e të anketuarve janë përgjigjur se do ta votonin Aleancën Kosova e Re - AKR, rreth 24.00% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk janë të sigurt se cilën parti do ta votonin, rreth 11.10% e të anketuarve kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje, ndërsa rreth 2.70% e të anketuarve janë përgjigjur se do të votonin për parti të tjera.




Graf. 3. Nëse pas një jave do të zhvilloheshin Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, cilën nga partitë e listuara më poshtë do ti votonit?

Nga kjo del se niveli i pjesëmarrjes në zgjedhje në periudhën e anketimit do të ishte rreth 65% ose pjesëmarrja më e lartë në zgjedhje që nga pas pavarësia e Kosovës. Pra, nga ky 65% i qytetarëve që potencialisht do të merrnin pjesë në zgjedhje, rreth 28.77% kanë deklaruar se do ta votonin Partinë Demokratike e Kosovës - PDK, rreth 27.23% kanë deklaruar se do ta votonin Lidhjen Demokratike e Kosovës - LDK, rreth 25.54% kanë deklaruar se do ta votonin Lëvizjen VETVENDOSJE- LVV, rreth 6.46% kanë deklaruar se do ta votonin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës - AAK, rreth 3.85% kanë deklaruar se do ta votonin Listën Serbe - LS, rreth 2.31% kanë deklaruar se do ta votonin Nismën për Kosovë - NISMA, rreth 1.85% kanë deklaruar se do ta votonin Aleancën Kosova e Re - AKR ndërsa rreth 4.15% kanë deklaruar se do të votonin për parti të tjera.



Graf. 4. Renditja e partive politike sipas përqindjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjedhje

Sa i përket **vendbanimit** të respondentëve nga ata që do ta votonin Partinë Demokratike të Kosovës rreth 32.6% janë nga qyteti, ndërsa 67.4% nga fshati; ata që do ta votonin Lidhjen Demokratike të Kosovës rreth 40.1% janë nga qyteti, ndërsa 59.9% janë nga fshati; ata që do ta votonin Lëvizjen VETVENDOSJE rreth 53.6% janë nga qyteti; ndërsa rreth 46.4% janë nga fshati; ata që do ta votonin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës rreth 47.6% janë nga qyteti, ndërkaq 52.4% janë nga fshati; ata që do ta votonin Listën Serbe rreth 52.0% janë nga qyteti; ndërsa 48.0% janë nga fshati; ata që do ta votonin Nismën për Kosovën rreth 26.7% janë nga qyteti dhe 73.3% nga fshati; ata që do ta votonin Aleancën Kosova e Re rreth 91.7% janë nga qyteti dhe vetëm 8.3% janë nga fshati; nga ata që nuk janë të sigurt se cilën parti do ta votonin rreth 42.9% janë nga qyteti, ndërsa 57.1% janë nga fshati; ata që kanë refuzuar të përgjigjen rreth 44.1% janë nga qyteti dhe 55.9% nga fshati, ndërkaq ata që kanë deklaruar që do të votonin parti të tjera rreth 40.7% janë nga qyteti, ndërsa 59.3% nga fshati.



Graf. 5. Respondentët sipas tipit të vendbanimit

Sa i përket **gjinisë** së respondentëve, nga ata që do ta votonin Partinë Demokratike të Kosovës rreth 49.2% janë meshkuj, ndërsa rreth 50.8% janë femra; nga ata që do ta votonin Lidhjen Demokratike të Kosovës rreth 52.5% janë meshkuj, ndërsa rreth 47.5% janë femra; nga ata që do ta

votonin Lëvizjen VETVENDOSJE rreth 53.6% janë meshkuj, ndërsa rreth 46.4% janë femra; ata që do ta votonin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës rreth 50.0% janë meshkuj dhe 50.0% femra; nga ata që do ta votonin Listën Serbe rreth 56.0% janë meshkuj, ndërsa rreth 44.0% janë femra; prej atyre që do ta votonin Nismën për Kosovën rreth 35.7% janë meshkuj, ndërsa rreth 64.3% janë femra; nga ata që do ta votonin Aleancën Kosova e Re rreth 38.5% janë meshkuj, ndërsa rreth 61.5% janë femra; nga ata që nuk janë të sigurt se cilën parti do ta votonin rreth 50.6% janë meshkuj dhe rreth 49.4% femra; prej atyre që kanë refuzuar të përgjigjen rreth 50.5% janë meshkuj dhe 49.5% femra, ndërkaq ata që kanë deklaruar që do të votonin parti të tjera rreth 50.0% janë meshkuj dhe 50.0% femra.

Sa i përket *moshës* së respondentëve, prej atyre që do ta votonin Partinë Demokratike të Kosovës rreth 18.7% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 25.1% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 20.9% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 20.9% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 9.6% janë nga mosha 51-60 vjeç, rreth 3.2% janë nga mosha 61-70 vjeç, si dhe rreth 1.6% janë nga mosha 71-75 vjeç.

Nga ata që do ta votonin Lidhjen Demokratike të Kosovës rreth 25.8% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 16.3% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 18.0% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 19.7% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 12.9% janë nga mosha 51-60 vjeç, rreth 5.6% janë nga mosha 61-70 vjeç dhe rreth 1.7% janë nga mosha 71-75 vjeç.

Prej atyre që do ta votonin Lëvizjen VETVENDOSJE rreth 35.2% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 16.4% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 15.8% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 19.4% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 9.7% janë nga mosha 51-60 vjeç, rreth 3.0% janë nga mosha 61-70 vjeç dhe 0.6% janë nga mosha 71-75 vjeç.

Nga ata që do ta votonin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës rreth 16.7% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 21.4% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 26.2% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 19.0% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 4.8% janë nga mosha 51-60 vjeç dhe rreth 11.9% janë nga mosha 61-70 vjeç.

Nga ata që do ta votonin Listën Serbe rreth 20.0% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 20.0% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 24.0% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 24.0% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 8.0% janë nga mosha 51-60 vjeç dhe rreth 4.0% janë nga mosha 61-70 vjeç.

Nga ata që do ta votonin Nismën për Kosovën rreth 35.7% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 21.4% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 21.4% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 7.1% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 7.1% janë nga mosha 61-70 vjeç dhe rreth 7.1% janë nga mosha 71-75 vjeç.

Nga ata që do ta votonin Aleancën Kosova e Re rreth 33.3% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 8.3% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 8.3% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 16.7% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 25.0% janë nga mosha 51-60 vjeç dhe rreth 8.3% janë nga mosha 71-75 vjeç.

Nga ata që nuk janë të sigurt se cilën parti do ta votonin rreth 22.2% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 13.4% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 23.4% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 15.5% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 18.8% janë nga mosha 51-60 vjeç, rreth 5.0% janë nga mosha 61-70 vjeç dhe 1.7% janë nga mosha 71-75 vjeç.

Nga ata që kanë refuzuar të përgjigjen rreth 34.2% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 15.3% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 20.7% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 18.0% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 6.3% janë nga mosha 51-60 vjeç, rreth 4.5% janë nga mosha 61-70 vjeç dhe 0.9% janë nga mosha 71-75 vjeç.

Nga ata që kanë deklaruar që do të votonin parti të tjera rreth 3.7% janë nga mosha 18-24 vjeç, rreth 18.5% janë nga mosha 25-30 vjeç, rreth 29.6% janë nga mosha 31-40 vjeç, rreth 14.8% janë nga mosha 41-50 vjeç, rreth 25.9% janë nga mosha 51-60 vjeç dhe rreth 7.4% janë nga mosha 61-70 vjeç.

Sa i përket *nivelet të edukimit* të respondentëve, prej atyre që do ta votonin Partinë Demokratike të Kosovës rreth 2.1% janë pa shkollim, rreth 15.4% janë me shkollim fillor, rreth 9.6% janë me shkollim të mesëm me kohëzgjatje prej 3 vjetësh, rreth 40.4% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, rreth 4.8% janë me shkollë të lartë, rreth 22.9% janë me shkollim universitar dhe 4.8% janë me studime të magjistraturës ose doktoraturës.

Nga ata që do ta votonin Lidhjen Demokratike të Kosovës rreth 1.7% janë pa shkollim, rreth 14.7% janë me shkollim fillor, rreth 14.1% janë me shkollim të mesëm me kohëzgjatje prej 3 vjetësh, rreth 49.2% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, rreth 3.4% janë me

shkollë të lartë, rreth 15.3% janë me shkollim universitar dhe rreth 1.7% janë me studime të magjistraturës ose doktoraturës.

Nga ata që do ta votonin Lëvizjen VETVENDOSJE rreth 1.8% janë pa shkollim, rreth 11.4% janë me shkollim fillor, rreth 13.3% janë me shkollim të mesëm me kohëzgjatje prej 3 vjetësh, rreth 45.2% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, rreth 1.8% janë me shkollë të lartë, rreth 24.7% janë me shkollim universitar dhe rreth 1.8% janë me studime të magjistraturës ose doktoraturës.

Prej atyre që do ta votonin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës rreth 16.7% janë me shkollim fillor, rreth 9.5% janë me shkollim të mesëm me kohëzgjatje prej 3 vjetësh, rreth 45.2% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, rreth 21.4% janë me shkollim universitar dhe 7.1% janë me studime të magjistraturës ose doktoraturës.

Nga ata që do ta votonin Listën Serbe rreth 12.0% janë me shkollim fillor, rreth 72.0% janë me shkollim të mesëm me kohëzgjatje prej 3 vjetësh, rreth 12.0% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh dhe 4.0% janë me shkollë të lartë.

Nga ata që do ta votonin Nismën për Kosovën rreth 21.4% janë me shkollim fillor, rreth 7.1% janë me shkollim të mesëm me kohëzgjatje prej 3 vjetësh, rreth 35.7% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, rreth 28.6% janë me shkollim universitar dhe 7.1% janë me studime të magjistraturës ose doktoraturës.

Nga ata që do ta votonin Aleancën Kosova e Re rreth 8.3% janë pa shkollim, rreth 25.0% janë me shkollim fillor, rreth 25.0% janë me shkollim të mesëm me kohëzgjatje prej 3 vjetësh, rreth 25.0% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, rreth 8.3% janë me shkollë të lartë dhe rreth 8.3% janë me shkollim universitar.

Nga ata që nuk janë të sigurt se cilën parti do ta votonin rreth 2.9% janë pa shkollim, rreth 23.8% janë me shkollim fillor, rreth 12.1% janë me shkollim të mesëm me kohëzgjatje prej 3 vjetësh, 43.1% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, rreth 4.2% janë me shkollë të lartë, rreth 11.7% janë me shkollim universitar dhe 2.1% janë me studime të magjistraturës ose doktoraturës.

Nga ata që kanë refuzuar të përgjigjen rreth 4.5% janë pa shkollim, rreth 11.7% janë me shkollim fillor, rreth 27.0% janë me shkollim të mesëm me

kohëzgjatje prej 3 vjetësh, rreth 32.4% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, rreth 5.4% janë me shkollë të lartë, rreth 14.4% janë me shkollim universitar dhe 4.5% janë me studime të magjistraturës ose doktoraturës.

Prej atyre që kanë deklaruar që do të votonin parti të tjera rreth 7.7% janë pa shkollim, rreth 19.2% janë me shkollim fillor, rreth 53.8% janë me shkollim të mesëm në kohëzgjatje prej 4 vjetësh, rreth 15.4% janë me shkollim universitar dhe rreth 3.8% janë me studime të magjistraturës ose doktoraturës.

Sa i përket **statusit të punësimit** të respondentëve, nga ata që do ta votonin Partinë Demokratike të Kosovës rreth 2.7% janë punëdhënës, rreth 28.9% janë të punësuar, rreth 2.7% janë që punojnë në pronën familjare, rreth 30.5% janë të papunë, rreth 10.2% janë studentë, rreth 17.6% janë shtëpiak/e dhe 5.9% janë të pensionuar.

Nga ata që do ta votonin Lidhjen Demokratike të Kosovës rreth 0.6% janë punëdhënës, rreth 26.0% janë të punësuar, rreth 8.5% janë të vetëpunësuar, rreth 2.3% janë që punojnë në pronën familjare, rreth 32.8% janë të papunë, rreth 10.7% janë studentë, rreth 16.4% janë shtëpiak/e dhe 2.3% janë të pensionuar.

Nga ata që do ta votonin Lëvizjen VETVENDOSJE rreth 30.1% janë të punësuar, rreth 9.0% janë të vetëpunësuar, rreth 0.6% janë që punojnë në pronën familjare, rreth 22.9% janë të papunë, rreth 20.5% janë studentë, rreth 12.7% janë shtëpiak/e dhe rreth 4.2% janë të pensionuar.

Nga ata që do ta votonin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës rreth 22.0% janë të punësuar, rreth 9.8% janë të vetëpunësuar, rreth 7.3% janë që punojnë në pronën familjare, rreth 39.0% janë të papunë, rreth 9.8% janë studentë, rreth 9.8% janë shtëpiak/e dhe rreth 2.4% janë të pensionuar.

Nga ata që do ta votonin Listën Serbe rreth 50.0% janë të punësuar, rreth 3.8% janë të vetëpunësuar, rreth 19.2% janë të papunë, rreth 19.2% janë studentë, rreth 3.8% janë shtëpiak/e dhe rreth 3.8% janë të pensionuar.

Nga ata që do ta votonin Nismën për Kosovën rreth 7.1% janë punëdhënës, rreth 50.0% janë të punësuar, rreth 7.1% janë të papunë, rreth 28.6% janë studentë dhe rreth 7.1% janë të pensionuar.

Nga ata që do ta votonin Aleancën Kosova e Re rreth 46.2% janë të punësuar, rreth 23.1% janë të papunë, rreth 23.1% janë studentë dhe rreth 7.7% janë shtëpiak/e.

Nga ata që nuk janë të sigurt se cilën parti do ta votonin rreth 1.3% janë punëdhënës, rreth 27.5% janë të punësuar, rreth 2.5% janë të vetëpunësuar, rreth 2.1% janë që punojnë në pronën familjare, rreth 34.2% janë të papunë, rreth 7.5% janë studentë, rreth 19.6% janë shtëpiak/e dhe rreth 5.0% janë të pensionuar.

Nga ata që kanë refuzuar të përgjigjen rreth 2.7% janë punëdhënës, rreth 29.1% janë të punësuar, rreth 4.5% janë të vetëpunësuar, rreth 3.6% janë që punojnë në pronën familjare, rreth 29.1% janë të papunë, rreth 15.5% janë studentë, rreth 9.1% janë shtëpiak/e dhe 4.5% janë të pensionuar.

Nga ata që kanë deklaruar që do të votonin parti të tjera rreth 4.0% janë punëdhënës, rreth 40.0% janë të punësuar, rreth 4.0% janë të vetëpunësuar, rreth 36.0% janë të papunë, rreth 12.0% janë shtëpiak/e dhe rreth 4.0% janë të pensionuar.

Sa i përket **sektorit të punësimit** të respondentëve, prej atyre që do ta votonin Partinë Demokratike të Kosovës rreth 67.2% janë të punësuar në sektorin privat, ndërsa rreth 32.8% janë të punësuar në sektorin publik.

Nga ata që do ta votonin Lidhjen Demokratike të Kosovës rreth 74.6% janë të punësuar në sektorin privat, ndërsa rreth 25.4% janë të punësuar në sektorin publik.

Nga ata që do ta votonin Lëvizjen VETVENDOSJE rreth 87.9% janë të punësuar në sektorin privat, rreth 10.6% janë të punësuar në sektorin publik dhe rreth 1.5% janë të punësuar në sektorin jo-qeveritarë.

Nga ata që do ta votonin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës rreth 82.4% janë të punësuar në sektorin privat, ndërsa rreth 17.6% janë të punësuar në sektorin publik.

Nga ata që do ta votonin Listën Serbe rreth 42.9% janë të punësuar në sektorin privat ndërsa rreth 57.1% janë të punësuar në sektorin publik.

Nga ata që do ta votonin Nismën për Kosovën rreth 100.0% janë të punësuar në sektorin privat.

Nga ata që do ta votonin Aleancën Kosova e Re rreth 80.0% janë të punësuar në sektorin privat dhe rreth 20.0% në sektorin publik.

Nga ata që nuk janë të sigurt se cilën parti do ta votonin rreth 84.0% janë të punësuar në sektorin privat, ndërsa rreth 16.0% janë të punësuar në sektorin publik.

Nga ata që kanë refuzuar të përgjigjen rreth 71.1% janë të punësuar në sektorin privat, kurse rreth 28.9% janë të punësuar në sektorin publik.

Nga ata që kanë deklaruar që do të votonin parti të tjera rreth 78.6% janë të punësuar në sektorin privat, ndërsa rreth 21.4% janë të punësuar në sektorin publik.

Sa i përket **regjionit** të responentëve, nga ata që do ta votonin Partinë Demokratike të Kosovës rreth 24.7% janë nga regjioni i Prishtinës, rreth 23.7% janë nga regjioni i Mitrovicës, rreth 18.8% janë nga regjioni i Prizrenit, rreth 10.2% janë nga regjioni i Pejës, rreth 15.6% janë nga regjioni i Ferizajt, rreth 4.8% janë nga regjioni i Gjakovës dhe rreth 2.2% janë nga regjioni i Gjilanit.

Nga ata që do ta votonin Lidhjen Demokratike të Kosovës rreth 30.5% janë nga regjioni i Prishtinës, rreth 7.9% nga regjioni i Mitrovicës, rreth 13.6% janë nga regjioni i Prizrenit, rreth 14.7% janë nga regjioni i Pejës, rreth 6.8% janë nga regjioni i Ferizajt, rreth 13.6% janë nga regjioni i Gjakovës dhe rreth 13.0% janë nga regjioni i Gjilanit.

Nga ata që do ta votonin Lëvizjen VETVENDOSJE rreth 34.3% janë nga regjioni i Prishtinës, rreth 9.6% janë nga regjioni i Mitrovicës, rreth 18.1% janë nga regjioni i Prizrenit, rreth 5.4% janë nga regjioni i Pejës, rreth 6.0% janë nga regjioni i Ferizajt, rreth 4.2% janë nga regjioni i Gjakovës dhe 22.3% janë nga regjioni i Gjilanit.

Nga ata që do ta votonin Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës 21.4% janë nga regjioni i Prishtinës, rreth 14.3% janë nga regjioni i Prizrenit, rreth 19.0% janë nga regjioni i Pejës, rreth 16.7% janë nga regjioni i Ferizajt dhe 28.6% janë nga regjioni i Gjakovës.

Nga ata që do ta votonin Listën Serbe rreth 16.7% janë nga regjioni i Prishtinës, 50.0% janë nga regjioni i Mitrovicës, rreth 4.2% janë nga regjioni i Ferizajt dhe 29.2% janë nga regjioni i Gjilanit.


Nga ata që do ta votonin Nismën për Kosovën rreth 7.1% janë nga regjioni i Prishtinës, rreth 85.7% janë nga regjioni i Prizrenit dhe 7.1% janë nga regjioni i Pejës.

Nga ata që do ta votonin Aleancën Kosova e Re rreth 21.4% janë nga regjioni i Prishtinës, rreth 14.3% janë nga regjioni i Prizrenit, rreth 19.0% janë nga regjioni i Pejës, rreth 16.7% janë nga regjioni i Ferizajt dhe 28.6% janë nga regjioni i Gjakovës.

Nga ata që nuk janë të sigurt se cilën parti do ta votonin rreth 23.5% janë nga regjioni i Prishtinës, rreth 13.0% janë nga regjioni i Mitrovicës, rreth 16.8% janë nga regjioni i Prizrenit, rreth 5.9% janë nga regjioni i Pejës, rreth 20.2% janë nga regjioni i Ferizajt, rreth 8.8% janë nga regjioni i Gjakovës dhe 11.8% janë nga regjioni i Gjilanit.

Nga ata që kanë refuzuar të përgjigjen rreth 1.8% janë nga regjioni i Prishtinës, rreth 19.1% janë nga regjioni i Mitrovicës, rreth 19.1% janë nga regjioni i Prizrenit, rreth 17.3% janë nga regjioni i Pejës, rreth 3.6% janë nga regjioni i Ferizajt, rreth 34.5% janë nga regjioni i Gjakovës dhe 4.5% janë nga regjioni i Gjilanit.

Nga ata që kanë deklaruar që do të votonin parti të tjera rreth 69.2% janë nga regjioni i Prishtinës dhe 30.8% janë nga regjioni i Prizrenit.



Graf. 6. Respondentët sipas regjionit

Falënderime

Ky Raport është përgatitur nga stafi i Lëvizjes FOL dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Ndërsa, të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL janë të publikuara në këtë ueb faqe: ëëë.levizjafol.org.

Rreth Lëvizjes FOL

Organizata është themeluar të mbështes qytetarin aktive, të rris transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve publike për të kontribuar në qeverisje të mirë dhe parandalim të korrupsionit. Për t'i përmbushur qëllimin e saj, organizata do të ndërmarrë aktivitetet si: debate dhe trajnime, konferenca, seminare dhe tryeza, publikime dhe hulumtime, avokim si dhe mbështetje teknike dhe institucionale, monitorimin e institucioneve publike si dhe mobilizim dhe rrjetëzim. Shpenzimi i fondeve publike, konflikti i interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL.